



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

dt 11.9.15

№ 12090/1

UDHËZIM

Nr. 24 Datë 11.9 2015

**“PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 30.11.2007
‘PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË
KËMBIMIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 2.11.2005, me propozimin e Komisionit *Ad-Hoc*, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 11.1, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“ 11.1 Për artikujt e karburanteve të tilla si: benzinë, gazoil, mazut, solar, vajgur, jet, gazi i lëngshëm (butan, propan), biodiesel (dhe të gjitha nënproduktet) Drejtoria e Vlerës Doganore harton shkresën dhe pas firmosjes nga titullarët e institucionit, jua dërgon degëve doganore dhe njësisve të tjera që ju nevojitet ky informacion. Publikimi i këtyre artikujve është çdo ditë pune.”.

2. Pika 17, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“17. Në vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi, para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet më pak se:

17.1 Për autoveturat:

a) Deri 1400 cc jo më pak se	130.000 lekë
b) Mbi 1400-1900 cc jo më pak se	200.000 lekë
c) Mbi 1900-2500 cc jo më pak se	325.000 lekë

d) Mbi 2500-3000 cc jo më pak se	400.000 lekë
e) Mbi 3000-4500 cc jo më pak se	500.000 lekë
f) Mbi 4500 cc jo më pak se	800.000 lekë

17.2 Kamionçina, furgona dhe kamionë:

a) Deri në 1.5 ton jo më pak se	400.000 lekë
b) Nga 1.5 ton deri në 3.5 ton jo më pak se	600.000 lekë
c) Nga 3.5 ton deri në 10 ton jo më pak se	850.000 lekë
d) Nga 10 ton deri në 15 ton jo më pak se	1.000.000 lekë
e) Mbi 15 ton jo më pak se	1.200.000 lekë

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SHKËLQIM CANI

